

Buletini i Lajmeve të Sigurisë Kibernetike

Shkurt 2023

SIGURIA KIBERNETIKE PRIORITET KOMBËTAR!



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt, datë 7 Shkurt 2023, AKCESK në bashkëpunim me OSCE in Albania, USAID, National Agency of Information Society/Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Albanian Association of Banks / Shoqata Shqiptare e Bankave, Soft Solution, R&T Group, One Albania dhe DigitAlb organizon konferencën “Sfidat e Sigurisë Kibernetike në Shqipëri”.

Të gjithë së bashku për një ekosistem kibernetik të sigurt në Shqipëri!

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E MIRËKUPTIMIT MIDIS AKCESK - ISRAEL NATIONAL CYBER DIRECTORATE



Forcimi i bashkëpunimit në fushën e sigurisë kibernetike midis AKCESK dhe Israel National Cyber Directorate - מערך הסייבר הלאומי u formalizua sot në Tel Aviv, nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, e cila synon rritjen e kapaciteteve profesionale dhe qëndrueshmërisë kibernetike.

ADRESIMI I SFIDAVE TË SIGURISË KIBERNETIKE NË FOKUS TË DISKUTIMEVE TË KONFERENCËS



Konferenca u hap nga Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK, njëkohësisht Koordinator Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Z. Igli Tafa, i cili theksoi se “Siguria dhe mbrojtja ndaj keqpërdorimit të internetit është sot një sfidë mbarë botërore. AKCESK është këtu për të mbrojtur të dhënat tuaja dhe sot është koha e duhur për tu mbledhur së bashku dhe për të adresuar sfidat që na presin.

Por ne nuk jemi vetëm, ne kemi mbështetjen e plotë të Qeverisë Shqiptare dhe të partnerëve të rëndësishëm ndërkombëtarë. Ne e dimë shumë mirë që çelësi i suksesit është bashkimi i aktorëve ndaj kësaj lufte. Vetëm duke qenë bashkë, duke ndarë informacione, duke rritur kapacitetet teknologjike dhe njerëzore, duke u ndërgjegjësuar të gjithë për sfidat që na presin dhe duke rritur standardet e përditshme, ne do të jemi të suksesshëm ndaj armiqve kibernetikë.”

Zëvendëskryeministrja Znj. Belinda Balluku u shpreh: “Siguria kibernetike është një element thelbësor për mirëfunksionimin e Qeverisë dhe të gjitha infrastrukturave të informacionit. Falë reagimit në kohën e duhur si dhe mbështetjes së vyer të partnerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë strategjikë ky sulm nuk e arriti synimin kryesor, që ai kishte për të gjuhëzuar shtetin dhe për shkatërrimin e këtyre infrastrukturave.”

